



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:047999

Datë: 18.09.2024

Numri i dokumentit: 06174472

P.nr.82/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurit A. B. nga L., Rruga "...", të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP/II.nr.318/23, të datës 16.02.2023, për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesen e Prokurorisë Themelore ne Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor me datën 12.09.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP/II.nr.318/23, të datës 16.02.2023 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurit:

A. B., i lindur me .., nga P. me vendbanim në L. rruga "..." pnr, ku edhe tani jeton, i biri i E. dhe nënës S., e gjinisë S., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pa dënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datën 14.10.2022, rreth orës 18:30, në L., i pandehuri A. B., pas një marrëveshje paraprake në bashkëveprim me të miturit S.N, B.N, me dashje e ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarit M. K., ashtu që e kanë goditur me grushta dhe shqelma në pjesët e ndryshme të trupit,-

-Me çka ka kryer veprën penale Sulm nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në konform të dispozitave të lartcekura dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe nenit 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si dhe neneve 493, 495 si dhe nenit 364 të KPPRK-së, të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumë prej 500-€, të cilin dënim i pandehuri është e obliguar që ta paguaj në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim, konfrom nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

I dëmtuari M. K. nga fsh.S. K. L., udhëzohen që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest të rregullt gjyqësor.

DETYROHET i pandehuri që kësaj gjykate, në emër të paushallit gjyqësor ti paguaj shumën prej 20- €, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit ti paguaj shumën prej 20-€, në afat prej 15 dite nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PTH-së në Prishtinë, PP/II.nr.318/23, të datës 16.02.2023, e ka akuzuar të pandehurin A. B. nga L., Rruga "...", për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe njëkohësisht ka kërkuar që të pandehurit t'i shqiptohet urdhër ndëshkimor - dënim me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Vlerësimi i akuzës

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi shqyrtoi provat që janë bashkangjitur aktakuzës respektivisht kallëzimit penal numër 2022-AH-1138 i datës 19.10.2022, raporti i policit hetues dt.19.10.2022, raporti fillestar i incidentit i dt.14.10.2022, procesverbal i marrjes në pyetje për të dëmtuarin M. K. i dt.13.10.2022, procesverbal i marrjes në pyetje dëmtuarin M. K. i dt.14.10.2022, procesverbal i marrjes në pyetje të dyshuarit A. B. i dt.17.10.2022, procesverbal i marrjes në pyetje dyshuar B. N. i dt.13.10.2022, procesverbal i marrjes në pyetje dyshuar S. N. i dt.14.10.2022, procesverbal i marrjes në pyetje dëshmitarin A. K. i dt.14.10.2022, raporti njoftues dt.14.10.2022, raporti i oficerit i dt.13.10.2022, si dhe shkresave të lëndës konstaton se ka prova të mjaftushme në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Baza ligjore

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se "Për veprat penale për të cilat parashihet dënim me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet, për të cilat prokurori i shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do t'i shqiptojë dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor".

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë apo me burgim deri në 3 vite, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 449 dhe 450 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompenzimin e viktimave të krimit u mur në bazë të nenit 36 të Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore-juridike

Vendimi për kërkesen pasurore-juridike u bazua në nenin 462 të KPPK-së, pasi që gjykata nuk ka prova të mjaftushme për të vërtetuar lartësim e dëmit.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN

P.nr.82/23, me datën 12.09.2024

Bashkëpunëtori Profesional

Gentiana Dakaj

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e marrjes së të njëjtit, kundërshtimi i drejtohet gjyqtarit individual të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2023:047999
Datë: 18.09.2024
Numri i dokumentit: 06174472